



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA LEZHË
DREJTORIA E SHËRBIMIT DHE KUJDESIT SOCIAL**Nr. 12854/2 Prot.Lezhë, më 21 / 07 /2025**NJOFTIM****“ PËR ORGANIZMIN E DËGJESËS PUBLIKE NË LIDHJE ME MIRATIMIN E PLANIT LOKAL TË VEPRIMIT PËR BARAZI, PËRFSHIRJE DHE PJESËMARRJEN E ROMËVE DHE EGJIPTIANËVE NË BASHKINË LEZHË PËR PERIUDHËN 2025–2030 ”**

Ligji nr.13/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe Ligji nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë” përcaktuan qartësisht detyrimin e Bashkisë për të identifikuar nevojat për shërbime të kujdesit shoqëror, për ti planifikuar dhe ngritur këto shërbime. Bashkia Lezhë është në procedura të hartimit të Planit Lokal të Veprimit për Barazi, Përfshirje dhe Pjesëmarrjen e Romëve dhe Egjiptianëve në Bashkinë Lezhë (2025-2030). Ky është një dokument që përfaqëson një hap thelbësor për përmirësimin e kushteve sociale, Plani i Veprimit 2025-2030 vjen pas një periudhe të gjatë mungese të planeve të dedikuara, duke qenë se dokumenti i fundit strategjik i kësaj natyre ka qenë Plani Vendor 2013-2015. Plani bazohet në parimet dhe objektivat e Planit Kombëtar të Veprimit për Barazi, Përfshirje dhe Pjesëmarrjen e Romëve dhe Egjiptianëve në Republikën e Shqipërisë (2021-2025), duke qenë kështu në të njëjtën linjë me politikat kombëtare dhe ndërkombëtare për të drejtat e njeriut dhe përfshirjen sociale. Kjo qasje i jep dokumentit një dimension strategjik të gjerë, që synon jo vetëm zgjidhjen e problemeve imediate, por edhe krijimin e mundësive të qëndrueshme për zhvillimin e këtyre komuniteteve.

Rëndësia e këtij plani qëndron në rolin e tij si një udhërrëfyes për vendimmarrësit lokalë dhe partnerët strategjikë për të adresuar barrierat e pabarazisë dhe për të krijuar një mjedis gjithëpërfshirës ku të gjithë qytetarët e Bashkisë Lezhë të kenë mundësi të barabarta në të gjitha fushat e lartpërmendura. Plani do të shërbejë si një platformë për forcimin e bashkëpunimit mes institucioneve, organizatave të shoqërisë civile dhe komuniteteve, duke kontribuar në përmbushjen e objektivave kombëtare dhe ndërkombëtare për barazinë dhe të drejtat e njeriut. Nëpërmjet zbatimit të këtij plani, Bashkia Lezhë do të tregojë edhe njëherë angazhimin e saj për një shoqëri më të drejtë dhe më gjithëpërfshirëse, duke kontribuar kështu në stabilitetin social dhe zhvillimin e qëndrueshëm.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Në vijim të procesit të konsultimit me publikun ju ftojmë të merrni pjesë në dëgjesën publike, ditën e mërkurë datë 20/08/2025 ora 11:00 pranë ambjenteve të Bibliotekës Publike. Gjatë takimit të dëgjesës publike do të bëhet prezantimi i Planit Lokal të Veprimit për Barazi, Përfshirje dhe Pjesëmarrjen e Romëve dhe Egjiptianëve në Bashkinë Lezhë për periudhën 2025–2030.

**NË MUNGESË DHE ME URDHËR
SEKRETARI I PËRGJITHSHËM**

Reinis Cela



**KRYETARI
Pjerin Ndreu**